



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0610**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amendamentuar me 09. 08. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Progobal" SH.P.K, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse në punë (aksesor)" me numër të prokurimit KEK-23-2997-1-1-1, me 16/10/2023, mori:

### **Vendim**

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Progobal" SH.P.K me nr. 2023/0610, e datës 23/08/2023, kurse vendimi i AK Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse në punë (aksesor)" me numër të prokurimit KEK-23-2997-1-1-1, **Mbetet në fuqi**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Progobal" SH.P.K

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A (KEK) në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 31.03.2023 ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje personale mbrojtëse në punë (aksesor)" me numër të prokurimit KEK-23-2997-1-1-1.

Me 20.08.2023, AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim ka anuluar aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Me 07.08.2023, OE "Progobal" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 15.08.2023, AK KEK sh.a, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues

si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Progobal" SH.P.K i pakënaqur me Vendimin e AK-së për anulim, me 23.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokoll 610/23.

#### *Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak*

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim të procedurës

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

*Deklarimi i Ankuesit lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues:* "Përgjigje në raportin e ekspertit. Raportin e ekspertit nr. 2023/0610 date 11.09.2023. Vlerësojmë punën e ekspertit që ka bërë analize profesionale, duke marrë rreth 90% të pretendimeve ankimore të OE Progobal, si të Bazuara, me të drejte, bazuar në faktet dhe argumentet e prezantuara. Ndërsa dhe për 3 pretendimeve tjera të kontestuara, oferta e Progobal përkundër dallimeve të papërfillshme me ato të DT, jemi të sigurtë se produktet e ofruara për këto 3 pozicione (1; 13; 20) janë me të avancuara nga aspekti i sigurisë, krahasu me ato të DT të caktuara nga ana e AK. Specifikimet teknike të Pajisjeve Personale për Mbrojtje në punë të vendosura nga AK në DT, janë qysh para 15 viteve, që nuk janë ripërtëri dhe ndryshu në raport me EN Standardet me të avancuara si dhe përbërja dhe kualiteti i materialeve nga atë cilat prodhohen. Në fazën e para ofertimit, kemi kërkuar 3 here sqarime shtese për artikuj të caktuar, në të cilët ka pasur lëshime si dhe përshkrime të EN Standardeve të vjetra që nuk përdoren më. Vlerësojmë se kualiteti i pajisjeve mbrojtëse dhe jo vetëm, nuk duhet të matet me trashësinë apo dhe peshën e produktit, sepse teknologjia e materialeve është avansuar ashtu që të jenë me të lehta në peshë apo dhe trashësi, ndërsa të ofrojnë siguri me të lartë.

Ne këtë aspekt, produktet e ofruara edhe për këto 3 pozicione nga Proglobal shpk janë me te avancuara qe do te thotë se ofrojnë nivel te sigurisë me te larte se sa qe është kërkuar ne DT. Ne vijim janë te dhënat teknike dhe EN Standardet për artikuj e DT si dhe artikujve te ofruar nga Proglobal shpk, qe lehtësisht konstatohet se produktet qe kemi ofru janë me te avancuara nga aspekti i sigurisë, përcjellë me EN Standarde shtese.

Pozicionin 1. Dorezat nga materiali Nitril qe është kërkuar te jene ne DT janë për mbrojtje nga materiet kimike sipas Standardit EN374-2; Si dhe për pune mekanike sipas Standardit EN420; EN388Dorezat nga materiali Polyvinil Chloride te ofruara nga OE Proglobal janë për mbrojtje nga materiet kimike sipas Standardit EN374-1; EN374-2; EN374-4; EN374-5; EN16523 Si dhe për pune mekanike sipas Standardit EN420; EN388Dorezat dorëzu nga OE Proglobal janë shume me te avancuara se sa është kërku ne DT, sepse ofrojnë siguri për përdorim për te gjitha materiet kimike. Pozicioni 20

Dorezat për saldues, ne DT është kërkuar qe te jene me gjatësi  $32 \pm 2\%$ . Dorezat për saldues te ofruara nga OE Pro global janë me gjatësi 35cm. Dorezat e dorëzuara nga OE Proglobal 3cm me te gjata ofrojnë siguri për përdorim dhe me te larte se sa është kërku ne DT. Dallimi ne gjatësi për 3 cm është ne te mire te AK respektivisht punëtorëve te cilët do ti përdorin për saldim. Pozicioni 13. Doreza gome neoprenë, është kërku ne DT te jene me trashësi 1.1mm. Me standardet: EN420: 2003 EN388: 2003 (3,1,2,1) EN374-1, EN 374-2, EN 374-3. Doreza gome neopren te ofruara nga OE Proglobal janë me trashësi 0.75mm, gjithashtu për mbrojtje nga materiet kimike sipas Standardit EN ISO 21420:2020;EN388:2016+A1:2018; EN ISO 374-1:2016+A1:2018 ; EN16523-1: 2015 ; EN ISO 374-2:2019 ; EN ISO 374-4: 2019 ; EN ISO 374-5:2016.//Dorezat dorëzu nga OE Proglobal janë shume me te avancuara se sa është kërku ne DT, sepse ofrojnë siguri për përdorim për te gjitha materiet kimike. Nuk qëndrojnë argumentet e AK qe te anulohet. Oferta e Proglobal shpk është e përgjegjshme dhe me çmimin me te ulte. Propozojmë qe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe te vendoset si ne dispozitiv”.

#### *Administrimi dhe vlerësimi i provave*

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohej nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

#### *Përgjigjet e AK-së lidhur me pretendimet ankimore në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim*

Pretendimet tuaja janë te pa bazuara pasi qe: Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka bere vlerësimin duke u bazuar ne kërkesat e dosjes se tenderit dhe legjislacionit ne fuqi te aplikuar ne Republikën e Kosovës. Oferta juaj nuk i ka plotësuar specifikat teknike te shume pozicioneve sipas aneksit 1 te dosjes se tenderit. Disa nga pikat te cilat e kane bere ofertën tuaj te papërgjegjshme janë dorezat neopren për te cilat është kërkuar trashësia te jete 1.1 mm ndërsa ju

keni ofruar 0.75 mm qe do te thote ka një devijim te trashësisë rreth 30% nga kërkesa e dosjes se tenderit, gjithashtu rendësi tjetër kane edhe pikat tjera si materiali, standardet, niveli mbrojtës te cilat për disa pozicione nuk janë ofruar sipas kërkesës se dosjes se tenderi e qe ka te beje me sigurinë e punonjësve te Korporatës.

#### *Pretendimet e Ankuesit “Inovix”*

- *Pretendimi i pare (I)*- Autoriteti kontraktues – KEK sha, vendimin e datës 15.08.2023, fillimisht e ka nxjerre jashtë afatit ligjor te përcaktuar me paragrafin 6, te nenit 108/A, te LPP-se, ku përcaktohet: - “Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shitesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë”. OE ankues, kërkesën për ri shqyrtim e ka parashtruar me datën 07.08.2023, përderisa AK, vendimin dhe refuzimin e ka nxjerr me datën 15.08.2023, pra jashtë afatit te paraparë me ligj. Po ashtu AK, sipas vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim, nuk i ka trajtuar pretendimet tona ankimore, siç përcaktohet me paragrafin 8 nënparagrafi 8.4, te nenit 108/A, te LPP-se ku përcaktohen rastet kur AK mund ta refuzoj kërkesën si te pa bazuar: “autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi”. Pra AK – KEK sha, nuk i ka trajtuar faktet dhe pretendimet tona çfarë ne kemi kërkuar. Arsyetimi i AK-se, për eliminim te ofertës sonë dhe i pa trajtuar me vendim lidhur me Dorëza gome mbrojtëse nga kimikatet – , me arsyetim, Materiali i dorezave është ofruar cotton lingin ndërsa është kërkuar nitril. Është ofruar gjatësia 35cm, nuk qëndron. Ne DT pozicion 1 është kërku, dorezat te jene nga Materiali nitril, pjesa e brendshme nga pambuku, me Standardin EN374-2; EN 420; EN388; Materiali i dorezave te ofruara PVC7335 është nga PVC (Polyvinyl Chloride) dhe cotton, Apo variant i asaj çfarë është përcaktuar ne dosje te tenderit. Ne piken 4.1, te FDT-se ofrimin e varianteve është autorizuar/lejuar, përkatësisht nuk është ndaluar. Ndërsa tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK-KEK, ka kërkuar, Katalog pjese te katalogut apo prezantime grafike dhe ose fotografi te produkteve me përshkrime teknike si dhe certifikate te produkteve ne lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.
- *Pretendimi i dytë (II)*- Bazuar ne kërkesat kualifikuese, OE “ProGlogal”, shpk, ka ofertuar ne pajtueshmëri me te gjitha kërkesat e kualifikimit, ka prezantuar produkte ne pajtueshmëri dhe sipas standardeve, duke prezantuar dëshmi katalogë dhe certifikatat e konformitetit për produktet e ofruara, prandaj arsyetimi i eliminimit te ofertës sonë, bie ndesh me nenin 52, paragrafi 3 dhe nenin 59, te LPP-se. Dorezat PVC7335 pjese e ofertës janë ofruar nga materiali PVC (Polyvinyl Chloride) rrjedhimisht është ekuivalent/i ngjashëm me nitril material. Pjesa e brendshme është gjithashtu nga materiali (cotton) pambuk. Dorezat e ofruara me oferte, ofrojnë siguri dhe me te larte se sa qe është kërku ne FDT dhe DT, dhe një gjë e tille është e lejueshme me LPP. Dorezat PVC7335 pjese e ofertës janë me te avansuara si ne përdorim ashtu dhe ne aspektin e sigurisë - janë te certifikuara me standardet e poshtë shënuara: EN ISO 21420:2020 ; EN388:2016 A1:2018 ; EN ISO 374-1:2016 A1:2018 ; EN16523- 1: 2015 ; EN ISO 374-2:2019 ; EN ISO 374-4: 2019 ; EN ISO 374-5:2016. Ne DT është kërku gjatësia e dorezës 30cm±2% Dorezat PVC7335 pjese e ofertës janë me gjatësi 35cm – dallimi është i papërfillshëm, ndërsa qe është ne dobi te AK, meqë siguria është me e larte për shfrytëzuesin/punëtorin, marre parasysh se dorezat janë për mbrojtje nga materiet kimike. Arsyetimi i AK, për doreza pune nga lëkura, se mungon gjatësia e dorezave, Madhësia e dorezës 10 është 25.4cm, Niveli i mbrojtjes është (4.1.3.3.X), nuk qëndron. Ne DT pozicioni 2 është kërku madhësia e dorezës 10, te jete me gjatësi 26cm ±1%. Niveli i

mbrojtjes nga rreziqet mekanike (4.1.3.1).

- *Pretendimi i tretë (III)*- Dorezat e lëkurës L-4 pjese e ofertës janë me gjatësi 25.4cm – dallimi është i papërfillshëm. Niveli i mbrojtjes te dorezave pjese e ofertës është (4.1.3.3.X). Dorezat pjese e ofertës janë me kualitet me te larte, për arsye: Ne DT është kërkuar rezistenca ndaj shpimit 1) Dorezat pjese e ofertës kane rezistenca ndaj shpimit 3) Nivel te sigurisë shtese kane dhe Rezistenca e prerjes ISO 13997 (A deri në F). Arsyetimi i AK, doreza pune dimri, se mungon gjatësia e dorezës, nuk qëndron. Ne DT pozicioni 3 është kërku gjatësia 26cm  $\pm 1\%$ .
- *Pretendimi i katërt (IV)*- Dorezat 330 pjese e ofertës dhe te kontestuara nga AK, janë me gjatësi 26cm. Arsyetimi i AK, helmete mbrojtëse industriale, se Mungon afati i qëndrueshmërisë, mungon pesha e helmetës, nuk qëndron. Ne DT pozicioni 5 është kërku - afati i qëndrueshmërisë te jete 5 vite- Pesha e helmetës te jete e përafërt 350g  $\pm 4\%$ , ku te gjitha këto te dhëna janë te përshkruara dhe konfirmuara. Helmeta QUARTZUP3 pjese e ofertës. Është me afat te qëndrueshmërisë 5 vite. Pesha e helmetës është 345gr. Arsyetimi i AK për maske mbrojtëse nga gazrat me filtër, nuk qëndron. Ne DT pozicioni 10 është kërku - Maske mbrojtëse te klasës 1. Sqarim Maska mbajtëse Class 1 – është maska me nivelin me te ulet te mbrojtjes. Zakonisht përdoret për kohe te shkurte përdorimi dhe kur s'ka rreziqe te larta. Filtri 757-N është shenja e prodhuesit Climax, nuk përcakton kualitetin parametri 757-N Filtri 757-N ka parametra shume me te ulte te mbrojtjes nga gazrat e ndryshëm, ne krahasim me filtrin BLS 400 SERIES pjese e ofertës.
- *Pretendimi i pestë (V)*- Maska BLS 5000 SERIES pjese e ofertës është e klasës 3 – kjo dmth se ofron siguri për 3 here me shume se sa qe është kërku ne DT (sa me i madhe parametri i klasës, për aq siguria është me e larte). Maska BLS 5000 ofron nivelin me te larte te sigurisë. Filtri BLS 400 SERIES pjese e ofertës plotëson dhe tejkalon kushtet e përcaktuara ne specifikimet teknike te DT ne krahasim me filtrin 757-N qe është kërkuar Filtri BLS 400 SERIES ka nivel te mbrojtjes me te larte – ABEK2 Ndërsa filtri ne DT, 757-N ka nivel te mbrojtjes me te ulte ABEK1 Arsyetimi i AK, për doreza gome/neopren, se ka ofruar trashësinë 0.75mm ndërsa është kërkuar 1.1mm, nuk qëndron. Ne DT pozicioni 13 është kërku dorezat te jene me trashësi 1.1mm Me standardet: EN420: 2003 EN388: 2003 (3,1,2,1) EN374-1, EN 374-2, EN 374-3. Pretendimi ankimor 6, Dorezat VE509 TOUTRAVO pjese e ofertës janë me trashësi 0.75mm. Trashësia apo dhe pesha e materialit nuk përcakton kualitetin e produktit. Avancimi i teknologjisë se materialeve ka bere qe te produktet te jene sa me te lehta. Dorezat VE509 TOUTRAVO ne oferte, ofrojnë siguri dhe me te larte se sa qe është kërku ne FDT dhe DT, qe është e lejueshme me LPP. VE509, plotësojnë standardet: EN ISO 21420:2020 ; EN388:2016 A1:2018 ; EN ISO 374-1:2016 A1:2018 ; EN16523-1: 2015 ; EN ISO 374-2:2019 ; EN ISO 374-4: 2019 ; EN ISO 374-5:2016. Dallimi ne trashësi është i papërfillshëm, ndërsa qe është ne dobi te AK, meqë siguria është me e larte për shfrytëzuesin/punëtorin meqë janë te certifikuara me shume EN Standarde, se sa është kërkuar ne DT, marre parasysh se dorezat janë për mbrojtje nga materiet kimike.
- *Pretendimi i gjashtë (VI)*- Rripi i sigurisë HAR35 pjese e ofertës tani si produkt i ri prodhohet me emërtim REVOLIN HAR35M. Qe plotëson dhe tejkalon kushtet dhe standardet e kërkuara ne DT, meqë janë te certifikuara me shume EN Standarde, si: EN365; EN358; EN361; EN363; EN364 Janë gjithsej 2 rripa te sigurisë dhe furnizimin do te bëjmë me produktin e ri REVOLIN HAR35M PROVA 5 – Rripi i sigurisë REVOLIN HAR35M Arsyetimi i AK, për doreza për saldues, se është ofruar gjatësi 35cm, madhësi 10, ndërsa është kërkuar gjatësi 32cm  $\pm 2\%$  dhe madhësi 11, nuk qëndron. Ne DT pozicioni 20 është kerku doreza për saldues me gjatësia 32cm  $\pm 2\%$ , madhësi 11. Janë gjithsej 2 rripa te sigurisë dhe furnizimin do te bëjmë me produktin e ri REVOLIN HAR35M PROVA 5 – Rripi i



sigurisë REVOLIN HAR35M Arsyetimi i AK, për doreza për saldues, se është ofruar gjatësi 35cm, madhësi 10, ndërsa është kërkuar gjatësi 32cm  $\pm 2\%$  dhe madhësi 11, nuk qëndron. Në DT pozicioni 20 është kërkuar doreza për saldues me gjatësi 32cm  $\pm 2\%$ , madhësi 11.

- *Pretendimi i shtatë (VII)*- Dorezat për saldues CA615K pjesë e ofertës janë me gjatësi 35cm. Marre parasysh se janë me të gjata dhe se do të përdoren për saldim, dmth siguria është me e madhe. Ndërsa dallimi në gjatësi është i papërfillshëm. Dorezat prodhohen me madhësi 9, 10, 11. AK -KEK, me rastin e porosisë mund të përcaktohet dhe zgjedhe madhësinë e dëshiruar Prova 6 – Doreza saldimi CA615K Arsyetimi i AK, për syzet mbrojtëse për saldues, se Mungon trashësia e xhamit, nuk qëndron. Në DT pozicioni 21 është kërkuar syze mbrojtëse për saldues me trashësi 2.6mm. Pretendimi ankimor 9 Syzet mbrojtëse për saldues TOBA3 pjesë e ofertës Janë të standardizuara me standardet: EN 166 1 F ; EN 169; EN175 F, ashtu sikurse është kërkuar dhe në Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme të DT trashësia e xhamit është 2.6mm Standardet e përcaktojnë dhe kualitetin e syzeve mbrojtëse për saldues, përfshi dhe trashësinë e xhamave. Prova 7 – Syzet TOBA3 Pra kompania jone ka prezantuar dëshmi siç është kërkuar në dosje të tenderit tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht në pikën 21.3, të FDT-se, është përcaktuar që: “Mostrat e produkteve do të kërkojnë të dorëzohen para nënshkrimit të kontratës vetëm nga OE fitues”. Arsyetimet e AK në Letrën standarde nuk qëndrojnë, madje bien ndesh me dispozitat e nenit 28 dhe 52, të LPP-se, ku paragrafi 3 përcakton: “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim”. Pra AK, me rastin e eliminimit të ofertës sonë ka dale jashtë kërkesave të përcaktuara në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për kontratë. Vet fakti që AK, ka kërkuar mostra të produkteve pas nënshkrimit të kontratës nënkupton që AK, gëzon të drejtën e aplikimit të dimensioneve cilësisë dhe të tjerave përgjatë realizimit të kontratës e gjë ndërlihet me nenin 81, të LPP-se – Menaxhimi i kontratës, rrjedhimisht nuk mund të eliminohemi për çështje të cilat nuk janë përcaktuar si kërkesa kualifikuese por kërkesa ekzekutuese. Përmes sqarimeve shtese AK – KEK, ka mundur që të qartësojë të gjitha produktet tona për të cilat janë shfaqur dilemat dhe siç përcaktohet me nenin 59 dhe 72, të LPP-se.

#### *Konstatimet dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues*

- *Konstatimi i parë (I)*- Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 610/23 është se AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 108/A të LPP-së. Konkretisht OE ankues pretendon se të njëjtë kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim me 07.08.2023 ndërsa AK nuk është përgjigjur deri me 15.08.2023. Pas analizimit të provave përmes E-Prokurimi eksperti shqyrtues konfirmon se kërkesa për rishqyrtim është bërë me 07.08.2023, ndërsa vendimi i AK-së është bërë me 15.08.2023 do thotë jashtë afateve ligjore të parapara me nenin 108/A. Sipas nenit 97 të rregullores 001/2022 për prokurim publik, pika “p”, Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim konsiderohet shkelje e rëndë. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.
- *Konstatimi i dytë (II)*- Pretendimi tjetër ankimorë është se AK nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore sipas kërkesës për rishqyrtim. Pas analizimit të vendimit të AK-së kemi gjetur se AK në mënyrë konkrete janë përgjigjur vetëm për trashësinë e dorezave neoprene, ku nga AK është kërkuar trashësia 1.1mm ndërsa OE ka ofruar 0.75mm. AK për gjitha pretendimet tjera ankimore janë përgjigjur në mënyrë të përgjithësuar se për disa pozicione nuk janë ofruar sipas kërkesës së dosjes që ka të bëjë me sigurinë e punonjësve. Edhe në këtë rast vlerësojmë se AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 108/A par.8 nënpar.8.4, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

- *Konstatimi i tretë (III)*- OE ankues në ankesën e tij ka shumë pretendime rreth përmbushjes/mos përmbushjes së specifikave teknike të caktuara nga AK. Për shumicën e pretendimeve ankimore sa i përket specifikave teknike konsiderojmë se OE i ka ofruar në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit ose kanë ofruar produkt ekuivalent në kuptim të nenit 28 par.6 të LPP-së. Pavarësisht dallimit në emërtim AK për shumicën e këtyre specifikave ka mund të kërkoj sqarime shtesë. Megjithatë në këtë raport do të ndalemi në 3 pozicione/elemente të cilat konsiderojmë se nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes dhe nuk mund të konsiderohen se janë ekuivalente me atë që është kërkuar nga AK në dosje të tenderit. Për pozicionin 1 është kërkuar doreza nga materiali “Nitril”, ndërsa OE ankues ka ofruar doreza nga materiali PVC. OE pretendon se kjo është vetëm variant i asaj çka është kërkuar dhe se variante nuk janë ndaluar me dosje të tenderit. Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe pas hulumtimeve të bëra, kemi gjetur se materiali Nitril përveç se është më i shtrenjtë, në të njëjtën kohë është material më I qëndrueshëm se materiali PVC, andaj konsiderojmë se në rastin konkret nuk mund të thuhet se dorezat nga materiali PVC janë ekuivalente me dorezat nga materiali Nitril, pasi dorezat nga materiali Nitril janë edhe më shtrenjta edhe më të qëndrueshme. Pika e dytë është specifikacioni për doreza për saldues, ku kërkesë e dosjes ka qenë doreza për saldues me gjatësi 32cm  $\pm 2\%$ , madhësi 11. Ndërsa OE ankues në ankesë konfirmim se për këtë pozicion kanë ofrua doreza me gjatësi 35cm, megjithatë OE ankues pretendon se “Marre parasysh se janë me te gjata dhe se do te përdoren për saldim, dmth siguria është me e madhe. Ndërsa dallimi ne gjatësi është i papërfillshëm”.
- Eksperti shqyrtues vlerëson se në rastin konkret tejkalohet toleranca  $\pm 2\%$  nga 32cm. Megjithëse OE ankues pretendon se dallimi është I papërfillshëm dhe me këtë ofrohet siguri edhe më e madhe, në rastin konkret vlerësojmë se është në diskrecion të AK-së të vlerësoj se nëse mospërputhja e dimensioneve të kërkuara është e pranueshme për AK-në. Sa i përket dorezave gome/neoprene, AK në specifikacion Teknik ka kërkuar trashësi prej 1.1mm, ndërsa OE ankues ka ofruar trashësi 0.75mm dhe pretendon se: “Trashësia apo dhe pesha e materialit nuk përcakton kualitetin e produktit. Avancimi i teknologjisë se materialeve ka bere qe te produktet te jene sa me te lehta”. Edhe në këtë rast vlerësojmë se dallimi I dimensioneve/trashësisë së dorezës nga materiali i njëjtë, nuk mund të këtë ekuivalent. Thënë ndryshe trashësia 0.75mm nuk mund të jetë ekuivalent me 1.1mm. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, me përjashtim të dorezave nga materiali Nitril (është ofruar PVC), dorezat për saldues (tejkalohe toleranca lejuar prej  $\pm 2$ ), si dhe trashësia për doreza neoprene ku është kërkuar 1.1mm (është ofruar 0.75mm).Konstatimet e ekspertit shqyrtues.

### *Konstatimet e Panelit Shqyrtues*

Me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, parashtrësas dhe dokumentet e Operatorit Ekonomik ankues dhe Autoritetit Kontraktues, dhe gjeti se ankesa e parashtruar nga OE “Inovix” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar, është pjesërisht e bazuar.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse,

kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se pretendimet janë pjesërisht të bazuara por që nuk ndikojnë në ndryshim të epilogut përfundimtar të ankesës. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, paneli shqyrtues në vlerësimin e tij të pavarur konsideron se është bërë vlerësimi sipas kërkesave të dosjes së tenderit, andaj në përputhje me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të Rregullores është anuluar tenderi sepse nuk ka ofertuar asnjë operator ekonomik i përgjegjshëm, ashtu siç është sqaruar edhe në raportin e ekspertit shqyrtues duke u vlerësuar që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se vendimi i AK-së për anulim të procedurës së prokurimit duhet të mbetet në fuqi.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: